



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 594/F Prot

Tiranë, më 29/06/2015

V E N D I M

Nr. 33, datë 29/06/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "My Call" sh.p.k.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 148 datë 15/06/2015, është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "My Call" sh.p.k, me objekt: Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21 i Ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar).

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij. Nga hetimi administrativ i ushtruar dhe provat e administruara pranë kontrolluesit, rezultoi se "My Call" sh.p.k nuk e ka përbushur detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit (neni 21).

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të Kontrollit Administrativ.

Mbas shkeljes së konstatuar nga grupi i hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit "My Call" sh.p.k ka paraqitur në procesverbal pretendimin se: Nuk ka qenë i informuar për këtë detyrim ligjor dhe se me prezencën e tij konfirmon plotësimin dhe dorëzimin e "Formularit të Njoftimit" për subjektin "My Call" sh.p.k.

Lidhur me pretendimin e kontrolluesit se "Ka patur mungesë informacioni për ligjin", vlen të theksohet se Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është miratuar dhe botuar në Fletoren Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës, është bërë i njohur për të gjithë publikun dhe është i detyrueshëm për zbatim. Nga miratimi i këtij ligji deri në momentin e ushtrimit të këtij hetimi administrativ ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet e tij, për më tepër që ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin e tij. Mosnjohja e ligjit nga ana e kontrolluesit, nuk përbën shkak ligjor për përjashtimin nga përgjegjësia e përbushjes së detyrimeve të Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 594/3 prot. dt. 17/06/2015 është njoftuar kontrolluesi "My Call" sh.p.k për tu

paraqitur pranë ambienteve të zyrës së Komisionerit më datë 29/06/2015 ora 12:10, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme të tij.

Kontrolluesi "My Call" sh.p.k është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar dhe njoftuar për seancën dëgjimore. Përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime të tjera dhe është shprehur se i qëndron pretendimit të shprehur në procesverbalin e hetimit administrativ të mbajtur nga inspektorët e Komisionerit, atë të mungesës së informacionit mbi ligjin në fjalë.

Nga verifikimi në regjistrin elektronik si dhe në protokollin e brendshëm të autoritetit "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", rezulton se kontrolluesi "My Call" sh.p.k, ka plotësuar "detyrimin për njoftim" më datë 23/06/2015.

Sipas Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, kontrolluesit kanë përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, e për pasojë, detyrimin për zbatimin e të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligj".

Bazuar në nenin 25/1 të ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën "kundërvajtje administrative" dhe dënohet me gjobë.

Në caktimin e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është riparuar menjëherë, çka tregon ndërgjegjësimin e subjektit të kontrolluar për zbatimin e ligjit.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "My Call" sh.p.k me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 40 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot në 29/06/2015

